

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr.254 REGJ.THEM

Tirane me 21.06.2010

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, e përbërë nga
GJYQATAR : ALBERT MEÇA

asistuar nga sekretare gjyqësore Vilma Mehmeti, me prezencën e organit të Prokurorisë perfaqesuar nga prokuror Hysni Mulaj, në seance gjyqësore me detyrë të hapura, sot më datë 21.06.2010 shpall këtë vendim lidhur me kërkesën penale që i përket :

KERKUES: A.K, i biri i (.....) dhe i (.....), i datelindjes (.....), lindur dhe banues në Tirane, perfaqesuar nga av. Bardhi Koci dhe Alberta Gega.

OBJEKTI: Kundershtim të vendimit të sekuestrimit datë 30.03.2007 të marrë nga prokuroria e rrethit Tirane për mjetin tip (.....) me targa (.....) e sekuestruar me datë 13.12.2006. Lenie e mjetit në ruajtje.

BAZA LIGJORE: Neni 212, 217, 218 i K .Pr. Penale .

Ne pretendimet perfundimtare avokati i kerkuesi kerkoi pranimin e kerkeses ndersa perfaqesuesi i Prokurorisë kerkoi rrezimin e kerkeses

Gjykata, pasi degjoi pretendimet e paleve si shqyrtoi provat dhe diskutoi ceshtjen në teresi

VEREN

Se kerkuesi A.K i është drejtuar Gjykatës së rrethit gjyqesor Tirane me një kerkese ku kundërshton vendimin e sekuestrimit të një automjetit tip MBW X5 si edhe lenien e këtij mjeti në ruajtje. Kjo kerkese është e pabazuar dhe si e tillë duhet rrezuar për shkak të meposhteme.

Nga ana e OPGJ pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tirane, me datë 14.12.2006 është bërë sekuestrimi i një automjeti tip BMW X5 që mbante targën (.....) me nr. shasi (.....) të drejtuar nga shtetasi A.K si edhe disa dokumenta si leje qarkullimi zviceriane me nr.(.....) e mjetit me targa (.....) në emër të shtetasit A.V, një police sigurimi, një vertetim hyrjeje, një dokument në gjuhë gjermane si edhe një targë metalike (.....). sekuestrimet e mesipërme janë pasquruar në proces verbalin e sekuestrimit të provave materiale datë 14.12.2006. Organi i prokurorisë, me vendimin datë 15.12.2006 ka vlerësuar sekuestron e mesipërme duke njoftuar edhe shtetasin A.K.

Pas kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale, me datë 30.03.2007 organi i prokurorisë ka vendosur “Pezullimin e hetimeve për procedimin penal nr.4356 të vitit 2006. Dërgimin e akteve Drejtorisë së Policisë Qarkut Tirane për hetime të metejshme dhe zbulimin e autoreve”.

Kerkuesi ka pretenduar se mjete i mesiperm duhet t'i kthehet atij ne ruajtje pasi ambientet ku mbahet nuk jane te pershtatshme, qendrimi i metejshem po demton dhe po i humbet vleren automjetit, ai (kerkuesi) eshte bleres me mirebesim dhe se do ta vendose mjete ne dispozicion sa here te jete e nevojshme.

Gjykata konstaton se nga ana procedurale nuk ka asnje shkak per pavlefshmeri te veprimeve te kryera nga organet e policise apo prokurorise, madje edhe nga ana e vete kerkuesit nuk eshte pretenduar nje fakt i tille. Duke qene keshtu, bazuar ne nenin 218 te K.Pr.Penale Gjykata vendos kthimin e sendeve te sekuestruara kur nuk ka dyshim per perkatesine e tyre. Ne rastin object gjykimi, jo vetem qe ka dyshime qe kerkuesit i perket ky send, por te gjitha provat provojne te kunderten e ketij fakti . Konkretisht :

1. Automjeti i mesiperm rezulton te jete denoncuar si i vjedhur ne Gjermani me date 13.02.2005 dhe ka patur targat gjermane (.....) ne pronesi te shtetases L.S.
2. Vertetimi i hyrjes ne dogane i sekuestruar kerkuesit rezulton te jete krejtesisht i fallsifikuar dhe se nuk i perket ketij automjeti.
3. Automjeti nuk ka patur asnjehere targa zviceriane dhe se i gjithe dokumentacioni i sekuestruar kerkuesit ne emer te shtetasit A.V eshte me te dhena te rreme.
4. Automjeti i sekuestruar nuk eshte pajisur me targa te shtetin shqiptar dhe se targat e vendosura ne momentin e sekuestrimit i perkasin nje tjetër automjeti, duke bere keshtu qe edhe perdorimi i targave shqiptare te jete nje rrethane e rreme.
5. Targat zviceriane gjithashtu jane te rreme pasi sic permendem me lart mjete i sekuestruar nuk rezulton te jete rregjistruar ne Zvicer.
6. Nje dokument i titulluar kontrate shitjeje ne gjuhen gjermane midis kerkuesit A.K dhe shtetasit A.V eshte krejtesisht i pavertete dhe paraqet rrethana te rreme. Vete kerkuesi ka deklaruar se mjete e ka blere ne afersi te stadiumit "Dinamo" ne qytetin e Tiranës nje shtetasi zvicerian dhe se nuk ka perpiluar asnje document lidhur me makinën.

Duke qene ne keto rrethana, Gjykata konstaton se nuk eshte objekt i ketij gjykimi konkluzioni i Prokurorise per pezullimin e hetimeve dhe interpretimi i bere ne vendimin perkates. Por, eshte e qarte se mjete i sekuestruar kerkuesit eshte i vjedhur dhe se ai (kerkuesi) nuk ka asnje prove per te justifikuar perdorimin e tij dhe aq me pak pronesine mbi kete send. Neni 217 dhe 218 i K.Pr.Penale kerkon si kusht te domosdoshem qe sendet e sekuestruara t'i kthehen personave qe i perkasin. Ne rastin konkret, pervec faktit se sendi i eshte sekuestruar kerkuesit, nuk egziston asnje e dhene se ky send i perket shtetasit A.K, perkundrazi, i gjithe dokumentacioni dhe targat e sekuestruar sebashku me sendin paraqesin te dhena te paverteta.

Vec sa me siper, kerkesa eshte e pabazuar edhe nga ana procedurale. Neni 301 i K.Pr.Penale parashikon se *"1. Kur vë sekuestron, sipas nenit 300, policia gjyqësore shënon në procesverbal shkakun dhe i dorëzon një kopje të aktit personit, të cilit i janë sekuestruar sendet. Procesverbali i dërgohet pa vonësë dhe sidoqoftë jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është zbatuar sekuestroja.*

2. Prokurori, brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme, me vendim të motivuar vleftëson sekuestron, në qoftë se ekzistojnë kushtet, ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara. Kopja e vendimit i njoftohet personit të cilit i janë sekuestruar sendet. Kundër tij mund të bëhet ankim në gjykatë brenda dhjetë ditëve nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nga personi të cilit i janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë t'i kthehen ato. Ankimi nuk pezullon zbatimin e sekuestros."

Nga vendimi i dates 15.12.2006 "Per vleftesimin e sekuestros" rezulton e provuar se ky vendim i eshte komunikuar dhe nenshkruar nga A.K. Ne interpretimin me te favorshem

per kerkuesin, ai ka marre dijeni edhe per kete vendim me date 30.03.2007, date ne te cilen organi i Prokurorise ka marre vendim per pushimin e hetimeve ne ngarkim te A.K. Duke qene keshtu, kerkesi i eshte drejtuar Gjykates jashte afatit 10 ditor te parashikuar nga ligji dhe rrjedhimisht kerkesa e tij eshte e pabazuar edhe nga ana procedurale.

Per keto aresye, Gjykata krijoi bindjen dhe bazuar ne nenin 218 dhe 301 te K.Pr.Penale

VENDOSI

Rrezimin e kerkeses se kerkuesit A.K me object “Kundershtim vendimi sekuestrimi dhe lenie te mjetit ne ruajtje” si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.

Shpenzimet procedurale i ngarkohen kerkuesit.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane Brenda 10 diteve.

U shpall me 21.06.2010

SEKRETARE
VILMA MEHMETI

GJYQTAR
ALBERT MEÇA